# METALHAFTGRUND 550




## PERSHKRIMI

Astar antikorroziv i cilësisë premium me aditivë specialë zinku për mbrojtjen e metaleve nga korrozioni me tharje të shpejtë

## KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Pa plumb dhe krom
- Mbrojtje nga korrozioni
- Mbulueshmëri e shkëlqyer
- Veti të shumë të mira mbushjeje
- Punueshmëri dhe nivelim perfekt
- Ngjyrë bardhë, zezë, gri, e kuqerremtë
- Ngjitje e fortë, elasticitet i lartë dhe tharje e shpejtë

## REKOMANDIMET PËR PËRDORIM

Rekomandohet të përdoret si astar mbi të gjitha sipërfaqet metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente të brendshme dhe kryesisht të jashtme. Përdoret për lyerjen e konstruksioneve metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente industriale, si për shembull kapanone, ura, shkallë, etj .

## TË DHËNA TEKNIKE

| | |
|---|---|
| Rezina | Rezinë alkide |
| Densiteti<br>EN ISO 2811-1 | 1,45±0,02 gr/ml |
| Mbetja e thatë<br>EN ISO 3251 | 75% |
| Shkalla e hollimit | 10 – 20% |
| Viskoziteti | 115 ± 5 KU |
| Koha e tharjes | 2 - 4 orë<br>Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur |
| Koha për rilyerje | 6 - 8 orë<br>Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur |
| VOC në produktin e gatshëm<br>(Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l) | ≤ 100 |
| VOC emetimi në ambient,<br>dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3) | ≥ 20 |

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqet nga boja e vjetër e dëmtuar, e pa ngjitur dhe pjesët e ndryshkura duke bërë zmerilimin e sipërfaqes. Me anën e procesit të larjes eleminoni të gjithë pluhurat e krijuar nga procesi i zmerilimit si dhe elemente të tjera që pengojnë ngjitjen si graso, vajra, etj.

## PËRGATITJA E PRODUKTIT

Fillimisht bëni hollimin e produktit duke përdorur solventin e duhur deri në viskozitetin e përshtatshëm për aplikim. Rekomandohet që përzierja e produktit me solvent të bëhet duke përdorur një mikser elektrik.

## APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit MetalhaftGrund 550 bëhet me anën e një pistolete me ajër, me furçë ose me rrul. Fillimisht hidhni produktin e përgatitur në enën mbajtëse. Më pas me anën e pistoletës bëhet hapja e produktit mbi sipërfaqen e metalit. Aplikimi bëhet duke aplikuar dy shtresa të njëpasnjëshme në mënyrë që të bëhet mbulimi sa më i mirë i sipërfaqes së metalit. Sigurohuni që të përftohet spesori i duhur i shtresës në mënyrë që të arrihet mbrojtja maksimale e metalit.

## RUAJTJA

36 muaj, me kusht që kanaçet të jenë të mbyllura dhe në kushte normale ruajtjeje.

## SHËNIME

• Rekomandohet që të shmanget aplikimi i produktit në temperatura nën 5ºC

## PAKETIMI

0.375lt 0.750lt 3lt